



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenet 11, 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nenet 14 dhe 15 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 04 qershor 2021, miratoi këtë,

VENDIM PËR VËNIEN NË DISKUTIM

Neni 1

Vëhet në diskutim publik:

- ***Propozim Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale me nr.prot.01-431/04-0014941/18 të datës 28 shkurt 2021***

Neni 2

Diskutimi publik sipas nenit 1, zgjat 30 ditë përkatësisht prej **07 qershor 2021 deri më 07 korrik 2021**. Debat i publik me qytetarë dhe mbahet më **14 qershor 2021** duke filluar nga **ora 10;00**, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhës - salla e mbledhjeve.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresat; **liridona.rrahmani@rks-gov.net** dhe **ejup.babatinca@rks-gov.net**; të cilat pastaj përcjellën në Drejtorinë përkatëse, brenda periudhës së diskutimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: **<http://kk.rks-gov.net/podujeve>** (*rubrika; aktet për diskutim publik*)

Neni 5

Diskutimi/debati publik zbatohet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdeset për përgatitjen e raportit nga diskutimi / debati publik dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot.01-070/05-0045287/21
Podujevë,
04 qershor 2021



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Propozim

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE

Podujevë, maj 2021

Në bazë të nenit 12.2 shkronja c), 40.2 shkronja g) dhe 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 2 paragrafët 1 dhe 3, nenet 8 dhe 13 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokalnr.03/L-049, nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPL) nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, nenet 15 paragrafi 2.3; 34 paragrafi 2.7 dhenenit 61paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i;

Propozon

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA,TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE nr.01-431/04-0014941/18

Neni 1

Me këtë Rregullore ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja për taksa,tarifa dhe gjoba komunale nr.prot.01-431/04-0014941/18 e datës 28 shkurt 2018.

Neni 2

Neni 6 fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

Taksa komunale vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

1. Subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarin e tyre në teritorin e Komunës së Podujevës lirohen nga taksa komunale vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste.
2. Subjektet afariste që pretendojnë shlyerjen e borgjit si pasojë e mosushtrimit të aktivitetit afarist mund të parashtrorjnë kërkesë Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik për shlyerjen e borgjit duke ofruar dëshmi nga Administrata Tatimore e Kosovës(Formularët e qarkullimit tre mujor zero-zero)për vitin apo vitet që pretendon sipas kërkesës ose dëshmin për pezullimin e aktivitetit të subjektit afarist për vitin përkatës lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.
3. Subjektet afariste të cilat kanë pësuar dëme si pasojë e fatkeqësive elementare, për ndonjë shkakë tjetër madhor ose arsye tjera objektive pa fajin e tyre,në bazë të dëshmimeve të lëshuara nga organet kompetente dhe sipas kërkesës së parashtruar mund të ju shlyhet ngarkesa për vitin në të cilin kanë pësuar dëme.
4. Kërkesa për shlyerjen e borxhit.....10.00 €
5. Kërkesa për çertifikatë si dëshmi për kryerjen e obligimeve.....1.00 €

Neni 3

Rregullorja hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

**Nr.prot.01-016/01-0040760/21
Podujevë
21 maj 2021**

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**